



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 169

Tiranë – E hënë, 1 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 103/2021, datë 28.10.2021	Për eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë..... 15309
Dekret i Presidentit nr. 13303, datë 29.10.2021	Për shpalljen e ligjit nr. 103/2021, “Për eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë”, dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të tij..... 15309
Vendim i Kuvendit nr. 81/2021, datë 28.10.2021	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane..... 15310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 27.10.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 595, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi dhe sistemimi i rrugës ‘Gjykata – Akademia e Marinës’ dhe rruga ‘Duro Shaska’ deri tek 7 pallatet, Vlorë, faza I’”, të ndryshuar..... 15311
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 456, datë 26.10.2021	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 713, datë 11.10.2018, “Për tarifat e licencimit të veprimtarive, të cilat përdorin burime të rrezatimit jonizues”..... 15312
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 412, datë 24.9.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 437, datë 23.7.2020, “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testeve molekulare RT-PCR për Sars-Cov-2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë, për kryerjen e testimit, për nevojë administrative”..... 15312
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Naim Shabani..... 15313

**LIGJ**
Nr. 103/2021**PËR EUROBONDIN QË DO TË
EMETOHET NGA MINISTRI I
FINANCEVE DHE EKONOMISË,
MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA
TATIMET E TAKSAT DHE TË
PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË
NGA IMUNITETI NË MARRËVESHJET
QË DO TË LIDHEN NGA MINISTRI I
FINANCEVE DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit “Eurobond”, në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre që i bashkëlidhen këtij ligji, lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondit dhe menaxherët bashkëdrejtues, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nga çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e eurobondeve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 28.10.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13303, datë 29.10.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 13303, datë 29.10.2021**PËR SHPALLJEN E LIGJIT NR. 103/2021,
“PËR EUROBONDIN QË DO TË
EMETOHET NGA MINISTRI I
FINANCEVE DHE EKONOMISË,
MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA
TATIMET E TAKSAT DHE TË
PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË
NGA IMUNITETI NË MARRËVESHJET
QË DO TË LIDHEN NGA MINISTRI I
FINANCEVE DHE EKONOMISË”, DHE
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN
NË FUQI MENJËHERË TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 103/2021, “Për Eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 103/2021, “Për Eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



VENDIM
Nr. 81/2021

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR
KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË
VEPRIMEVE TË ORGANEVE PUBLIKE
NË PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN
DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTEVE
TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, të neneve 5, 6, 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar, me propozimin e një të katërtës së deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane. Ky hetim do të synojë nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, garantimin e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut të lirë dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis të pastër.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ana e organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane.

2. Verifikimi i pasojave ekonomike në buxhetin e shtetit shqiptar, si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të organeve publike.

3. Verifikimi i efekteve mjedisore dhe pasojave mbi konkurrencën dhe tregun e lirë.

4. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe parimit të mosdiskriminimit.

5. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave të përshtatshme ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

6. Rekomandime për marrjen e masave të përshtatshme duke ndërgjegjësuar hallkat e

administratës shtetërore mbi aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e mjedisit.

7. Vlerësimi i nevojës për përafrimin e legjislacionit për koncensionet dhe mjedisor, me direktivat dhe praktikatat më të mira të BE-së.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, miratime, ndryshime apo korrigjime të kuadrit ligjor dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për fillimin e çështjes penale.

V. Komisioni hetimor përbëhet nga 15 anëtarë si më poshtë:

1. Jorida Tabaku	kryetare	PD
2. Ermonela Felaj	zëvendëskryetare	PS
3. Arben Pëllumbi	anëtar	PS
4. Eduard Shalsi	anëtar	PS
5. Etjen Xhafaj	anëtar	PS
6. Anila Denaj	anëtare	PS
7. Fadil Nasufi	anëtar	PS
8. Antoneta Dhima	anëtare	PS
9. Besion Ajazi	anëtar	PS
10. Edmond Spaho	anëtar	PD
11. Helidon Bushati	anëtar	PD
12. Dhurata Çupi	anëtare	PD
13. Belind Këlliçi	anëtar	PD
14. Luçiano Boçi	anëtar	PD
15. Lefter Gështenja	anëtar	PD
1. Jurgis Çyrbja	anëtar zëvendësues	PS
2. Denis Deliu	anëtar zëvendësues	PS
3. Luan Baçi	anëtar zëvendësues	PD
4. Ina Zhupa	anëtare zëvendësuese	PD

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit



të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 28.10.2021.

VENDIM
Nr. 636, datë 27.10.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 595, DATË 31.8.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘NDËRTIMI DHE
SISTEMIMI I RRUGËS ‘GJYKATA –
AKADEMIA E MARINËS’ DHE RRUGA
‘DURO SHASKA’ DERI TEK 7
PALLATET, VLORË, FAZA I”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 595, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra “... 134 790 025 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëzet e pesë) ...” zëvendësohet me “... 135 335 175 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e treqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë)”.

b) Pika 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 135 335 175 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e treqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 134 790 025 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëzet e pesë) lekë nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

- 545 150 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Vlorë.”.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë.”.

ç) Tabelave bashkëlidhur vendimit u shtohet edhe tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**LISTA SHITESË E PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME QË
SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI DHE SISTEMIMI I
RRUGËS ‘GJYKATA – AKADEMIJA E MARINËS’ + RRUGA ‘DURO SHASKA’
DERI TEK 7 PALLATET, VLORE, FAZA I”**

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësuar/ m ²	Çmimi në lekë /m ²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
					/m ²				
1	Bp. Sadiku	8602	36/277	truall		50	10,903	545,150	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale					50		545,150	

Shënime:

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

UDHËZIM

Nr. 456, datë 26.10.2021

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN**NR. 713, DATË 11.10.2018,****“PËR TARIFAT E LICENCIMIT TË
VEPRIMTARIVE, TË CILAT PËRDORIN
BURIME TË RREZATIMIT JONIZUES”**

Në zbatim të nenit 7, germa “a”, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 713, datë 11.10.2018, “Për tarifatat e licencimit të veprimtarive, të cilat përdorin burime të rrezatimit jonizues”, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1 të udhëzimit shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2, me përmbajtjen si vijon:

“1/1. Tarifatat e përcaktuara në këtë udhëzim janë për çdo burim ose pajisje për të cilin realizohet ekspertizë.

1/2. Për procedurën e rilicencimit të veprimtarive që nuk kanë ndryshim në ekspertizën e kryer, paguhet gjysma e tarifës së përcaktuar për licencimin e veprimtarisë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

URDHËR

Nr. 412, datë 24.9.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN**NR. 437, DATË 23.7.2020,****“PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS
Ë KRYERJES SË TESTIMEVE
MOLEKULARE RT-PCR PËR SARS-COV-
2 DHE NJOHJES SË LABORATORËVE
JOPUBLIKË, PËR KRYERJEN E
TESTIMIT, PËR NEVOJA
ADMINISTRATIVE”**

Në zbatim të nenit 100, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 3926, datë 22.9.2021, të Komitetit Teknik të Ekspertëve,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 437, datë 23.7.2021, “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testimeve molekulare RT-PCR për Sars-Cov-2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë, për kryerjen e testimit, për nevoja administrative” bëhet një ndryshim, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“Laboratorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri, kryejnë edhe testimin e antigenit, sipas



udhëzimeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

KËRKESË

Shtetasi Alket Shabani kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të zhdukur të shtetasit Naim Murat Shabani, më datë 31 korrik 1997.

KËRKUES
Alket Shabani

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë